



## THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

### "Përkrahja e bizneseve START-UP në komunën e Rahovecit"

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm përmes kësaj thirrje ju bënë ftesë publike bizneseve fillestare ose Start-UP që veprojnë në territorit të Komunës e Rahovecit, të aplikojnë për të përfutur nga skema e mbështetjes e cila do të ofrohet përmes subvencioneve me mjete financiare.

#### 1. Synimet e Thirrjes

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është zhvillimi ekonomik lokal i balancuar përmes përkrahjes së bizneseve fillestare ose Start-UP në komunën e Rahovecit.

Synimet specifike të kësaj ThPP janë:

- Gjenerimi i vendeve të reja të punës.
- Rritja e numrit të bizneseve në komunën e Rahovecit.

#### 2. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme indikative për këtë thirrje është 15,350.00€

Subvencioni do të jepet për:

-Bizneset Start-UP ose bizneset fillestare.

#### 3. Kriteret e aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe juridik;

Aplikanti/ja duhet:

- Të jenë shtetas të Kosovës, banor/e rezident i komunës së Rahovecit (dëshmohet me kopjet e letërnjoftimit),
- Bizneset fillestare apo Start-UP duhet të jenë të regjistruara jo më herët se nga 01.01.2024.
- Bizneset e regjistruara duhet të kenë të kryera të gjitha obligimet ndaj Komunës së Rahovecit.

#### **4. Sektorët që nuk do të përkrahën:**

- Bujqësia
- Ndërtimtaria
- Tregtia

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

-Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për personat fizik:

- Formulari i aplikimit
- Projekt propozimi
- Kopja e Letërnjoftimit
- Vërtetimi që i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës së Rahovecit

**Vërejtje:** Personat fizik pas shpalljes si përfitues të kësaj thirrje obligohen që të regjistrojnë biznesin në zyrën e QKB-së në Rahovec dhe të sjellin Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit së bashku me vërtetimin e llogarisë bankare në emër të biznesit, dokumente të cilat duhet të i dorëzojnë në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në komunën e Rahovecit.

-Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për personat juridik;

- Formulari i aplikimit
- Projekt propozimi
- Certifikata e biznesit së bashku me informatat
- Kopja e Letërnjoftimit
- Vërtetim që i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës së Rahovecit
- Konfirmimin e xhirologarisë bankare në emër të biznesit
- Vërtetimin nga ATK-ja.

#### **5. Mënyra e Aplikimit**

Aplikacioni mund të shkarkohet në WEB-faqe të Komunës së Rahovecit, ose të tërhiqet në zyrën e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Aplikimi do të jetë online në adresat elektronike: [fidan.hoti@rks-gov.net](mailto:fidan.hoti@rks-gov.net) dhe [tourism.rahovec@gmail.com](mailto:tourism.rahovec@gmail.com) në formën e PDF, dhe në formën fizike në dy kopje në zyrën e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm „Komuna e Rahovecit Rr. “Dëshmorët e Pashtrikut” p.n. kati i parë.

Për informata shtesë nr. kontaktues +383 49 884-575

#### **6. Afati për dorëzimin e aplikacionit .**

Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga data: 08 tetor,2024 deri me datën 20 tetor, 2024.